

VENDIM
Nr. 17, datë 10.1.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS
PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR MBROJTJEN E INFORMACIONIT
KONFIDENCIAL”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 46, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 20, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe neneve 19 dhe 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për miratimin e rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial, të përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s,

konstatoi se:

- Në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ERE ka kompetencën të hartojë draftrregulloren për mbrojtjen e informacionit konfidencial.

- Ky draft është hartuar në respektim të parashikimeve të dispozitave të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, duke dhënë orientim të përgjithshëm, në lidhje me llojin e informacionit tregtar që mund të cilësohet konfidencial, si dhe rrethanat apo llojin e informacionit që për shkak të parashikimeve të ligjit përjashtohet nga konfidencialiteti.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial”.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti